


Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Nëntor 2020

Tiranë, më 23 Dhjetor 2020: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Nëntor 2020, janë 360.343. Krahasuar me Nëntor 2019, ky tregues rezulton me rënie 48,1 %. Në Nëntor 2020, hyrjet e shtetasve të huaj në territorin shqiptar janë 148.362, krahasuar me Nëntor 2019, ky numër ka rënë me 44,7 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri në njëmbëdhjetëmujorin 2020 është 2.477.003, duke rënë me 59,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019 (tab.1).

Përgjatë njëmbëdhjetë muajve të 2020, Kosova ka rënien më të ulët të hyrjeve të shtetasve në Shqipëri me 40,4 %, ndërsa rënien më të madhe e ka pasur Spanja me 90,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 (tab.2).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Nëntor 2020



Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori shqiptar, gjatë muajit Nëntor 2020, janë 366.335 duke shënuar një rënie me 53,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Nëntor 2020 janë 208.183. Krahasuar me Nëntor 2019, ky numër ka rënë 56,6 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Nëntor 2020, janë 158.152. Krahasuar me Nëntor 2019, ky numër ka rënë 48,5 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga Shqipëria në njëmbëdhjetëmujorin 2020, është 2.691.130 duke rënë 50,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab.1).

Për publikim 23/12/2020

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj, Nëntor 2020

Periudha	Nëntor 2019	Nëntor 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Nëntor 2019	Janar-Nëntor 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Gjithsej	693.951	360.343	-48,1	11.206.071	4.976.451	-55,6
Shqiptarë	425.775	211.981	-50,2	5.088.741	2.499.448	-50,9
Të Huaj	268.176	148.362	-44,7	6.117.330	2.477.003	-59,5
Dalje Gjithsej	787.359	366.335	-53,5	11.397.031	5.172.221	-54,6
Shqiptarë	480.176	208.183	-56,6	5.436.520	2.691.130	-50,5
Të Huaj	307.183	158.152	-48,5	5.960.511	2.481.091	-58,4

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj, Nëntor 2020

Shtetet	Nëntor 2019	Nëntor 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Nëntor 2019	Janar-Nëntor 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	74.340	69.942	-5,9	2.171.329	1.293.712	-40,4
Maqedoni	22.120	28.558	29,1	712.878	338.309	-52,5
Greqi	41.433	4.401	-89,4	539.915	197.731	-63,4
Itali	23.700	6.679	-71,8	435.956	113.841	-73,9
Angli	7.032	2.255	-67,9	124.540	49.553	-60,2
Mali i zi	30.965	19.987	-35,5	338.981	155.487	-54,1
Poloni	732	132	-82,0	131.767	24.087	-81,7
SHBA	4.842	1.739	-64,1	114.765	22.500	-80,4
Spanjë	922	68	-92,6	28.167	2.613	-90,7
Gjermani	4.433	1.151	-74,0	161.575	36.209	-77,6
Zvicër	1.304	882	-32,4	62.120	14.923	-76,0
Të tjera	56.353	12.568	-77,7	1.295.337	228.038	-82,4
Gjithsej/Total	268.176	148.362	-44,7	6.117.330	2.477.003	-59,5

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit, Nëntor 2020

Periudha	Nëntor 2019	Nëntor 2020	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Nëntor 2019	Janar-Nëntor 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	268.176	148.362	-44,7	6.117.330	2.477.003	-59,5
I. Personale	260.122	137.758	-47,0	6.025.328	2.372.332	-60,6
1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor, etj.	250.436	133.417	-46,7	5.833.064	2.303.861	-60,5
2. Qëllime fetare	39	51	30,8	756	298	-60,6
3. Udhëtarë transit	9.647	4.290	-55,5	191.508	68.173	-64,4
II. Biznes dhe profesionale	8.054	10.604	31,7	92.002	104.671	13,8

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit, Nëntor 2020

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Nëntor 2019	109.518	33.764	550.669	124.614	31.762	630.983
Nëntor 2020	34.580	15.054	310.709	36.007	10.031	320.297
Ndryshimi vjetor (%)	-68,4	-55,4	-43,6	-71,1	-68,4	-49,2
Janar-Nëntor 2019	1.515.186	785.095	8.905.790	1.426.985	781.025	8.401.662
Janar-Nëntor 2020	606.651	204.872	4.164.928	615.295	213.324	4.343.602
Ndryshimi vjetor (%)	-60,0	-73,9	-53,2	-56,9	-72,7	-48,3

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor etj.;
2. Qëllime fetare;
3. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 "Për Kontrollin Kufitar", neni 17 "Lehtësimi i verifikimeve Kufitare", ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.